



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 231/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 21.05.2021, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e operatorit ekonomik “Biometric Albania” SHPK në procedurën e prokurimit me Nr. REF-84273-01-19-2021, me objekt: “F.V pajisje për sallat operatore të Spitalit Rajonal Shkodër”, me fond limit 41 632 222.22 lekë pa TVSH, zhvilluar me date 17.02.2021, nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Shkodër.

Ankimues: “Biometric Albania” SHPK
Rruga “Vllazën Huta”, Pallati i Ri “Vila Park”, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Spitali Rajonal Shkodër
L. Skenderbeg, Shkodër

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, Vendim i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë

5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 20.01.2021 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit me Nr.REF-84273-01-19-2021, me objekt: “F.V pajisje për sallat operatore të Spitalit Rajonal Shkodër”, me fond limit 41.632.222,22 lekë pa TVSH, zhvilluar me date 17.02.2021, nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Shkodër.

II.2. Në datën 03.03.2021 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar.

Nga vlerësimi i bërë nga KVO-ja rezulton si më poshtë:

- | | | |
|----|--------------------------|-------------------------------|
| 1. | “Albaphoto” SHPK | 36.861.000 lekë, skualifikuar |
| 2. | “Biometric Albania” SHPK | 23.470.000 lekë, skualifikuar |
| 3. | “Medfau” SHPK | 38.700.000 lekë, skualifikuar |
| 4. | “Montal” SHPK | 29.880.000 lekë, skualifikuar |
| 5. | “Health&Light” SHPK | 30.924.000 lekë, skualifikuar |

Operatori ekonomik “Biometric Albania” SHPK rezulton i skualifikuar nga KVO-ja, pasi:

1. Kataloget nuk perputhen me specifikimet teknike pasi diametri i fushes se drites eshte 120-350 mm;

2. Shtreterit e kirurgjise se pergjithshme nuk perputhen sepse kendi i levizjes pergjate aksit horizontal majtas/djathtas eshte 30°.

3. Rrotullimi i pjastres se kembeve duhet te jete deri ne 90 ° dhe jo 180° siç eshte paraqitur”.

II.3. Në datën 09.03.2021, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, nëpërmjet të cilës kundërshton skualifikimin e tij në procedurën e prokurimit. Konkretisht pretendohet si vijon:

“ [...]

Kontestojme vendimin e KVO me argumentet e mëposhtme:

Bazuar ne Ligjin 9643 date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik" te ndryshuar, neni 63 pika 1 dhe pika 2 qe kane te bejne me "Te drejtat e Personit te Interesuar", ju drejtohem me kete ankese, per te kundërshtuar vendimin e KVO per skualifikimin e ofertes se OE BIOMETRIC ALBANIA dhe duke ju paraqitur argumentet tona per pretendimet e ngritura.

1. Ne lidhje me pretendimin e pare te mosplotesimit te kriterit "Diametri i fushes se drites eshte 120-350mm", po ju japim sqarimet tona si ne vijim:

Per sa i perket artikullit Nr. 3 “Ndricules per sallat e operacionit”, specifikimi i kerkuar per kete produkt ne Shtojcen e paraqitur ne APP te dates 11.02.2021 ka qene:

Diametri i fushes se drites (Light Field Diameter) minimalisht ne diapazonin nga (120-150mm) d ne me shume se 280mm i rregullueshem ose ne diapazon me te gjere.

Produkti i ofruar nga kompania jone, ashtu sic edhe paraqitet ne katalogun "Katalog Huifeng_Art 3" e ka kete specifikim ne diapazonin 120-350 mm (te rregullueshem).

Size of light field diameter (adjustable)	120-350 mm
---	------------

Per sa me siper, kuptohet qarte se produkti i ofruar nga ana jone, ploteson 100% specifikimet e kerkuara ne DST dhe i tejkalon ato. Eshte kerkuar qe diametri i fushes se drites te jete me shume se 280 mm i rregullueshem ose ne diapazon me te gjere, pra oferta jone per kete parameter eshte superiore, duke mundesuar diameter te fushes se drites te rregullueshem me diapazon me te gjere se 280 mm sikurse eshte specifikuar, diapazon qe arrin deri ne 350 mm. Pra aparati jone i ploteson operatorit diametrin e kerkuar te fushes se drites 280 mm, por mundeson diapazon edhe me te gjere, deri 350mm, ne perputhje te plote me specifikimet e kerkuara ne DST (pra diapazon

me te gjere), nese operatori i specializuar qe do te perdore kete aparat, eshte i interesuar ta perdori per teknika specifike operimi.

Operatori mund ta vendose kete parameter ne baze te llojit te procedures kirurgjikale, duke filluar nga vlera minimale 120mm dhe duke e rregulluar ate ne 150, 280 e deri ne vleren maksimale 350mm.

Pra, duket qarte qe ky kriter i kerkuar, plotesohet dhe tejkalohe ne diapazon, duke ofruar nje vlere minimale 120 mm (ashtu sic edhe kerkohe 120-150 mm) deri ne 350 mm (vlere me e madhe se 280mm), qe do te thote nje diapazon me i gjere, si dhe i rregullueshem, pikerisht 100% sipas kerkesave ne DST.

2. Ne lidhje me pretendimin e dyte te mosplotesimit te kriterit "Shtreterit e kirurgjise se pergjithshme nuk perputhen sepse kendi i levizjes pergjate aksit horizontal majtas/djathtas eshte 30°", po ju japim sqarimet tona si ne vijim:

Per sa i perket artikullit Nr.1 "Shtreter Operatore per salle operacioni per perdorim kirurgjise te pergjithshme", specifikimi i kerkuar per kete produkt, ne Shtojcen e paraqitur ne APP te dates 11.02.2021 ka qene:

Kendi i levizjes pergjate aksit horizontal (Lateral Tilt Left/Right)

Majtas nga 15°-20°

Djathtas nga 15°-20°

Produkti i ofruar nga kompania jone, ashtu sic edhe paraqitet ne katalogun "Katalog Alvo_Art 1_2", e ka kete specifikim te rregullueshem ne diapazonin 30° / -30° (Lateral Tilt Adjustment).

Technical parameters ALVO Etiuda		
1	Tabletop length	2100 mm
	4, 5 sections	2200 mm
2	6 sections	
	Tabletop width	500 mm
	Tabletop width (with side rails)	560 mm
3-4	Height adjustment (without pads) - Mobile base, tables with manual longitudinal shift	700 - 1030 mm
	Height adjustment (without pads) - Mobile base, tables with powered longitudinal shift	730 - 1060 mm
	Height adjustment range (without pads) - Supermobile base, tables with manual longitudinal shift	700 - 1030 mm
	Height adjustment range (without pads) - Mobile base, manual longitudinal shift, double electrohydraulic column	615 - 1065 mm
8	Back rest adjustment	85° / -45°
9	Foot rest adjustment	20° / -90°
12	Foot rest abduction	180°
10	Lateral tilt adjustment	30° / -30°
7	Head rest adjustment	45° / -45°

The right to

Pra, kompania jone ka ofruar nje produkt me nje diapazon me te gjere te kesaj levizje, qe ploteson 100% specifikimet e kerkuara dhe i tejkalon ato, pa kerkuar kosto shtese.

Levizja laterale (anesore) prej $\pm 30^\circ$ perben nje avantazh, sidomos ne nderhyrjet kirurgjikale nefrologjike-uologjike, ku eshte i nevojshem rrotullimi anesor i shtratit ne nje kend me te gjere se ai i kerkuar $20^\circ / -20^\circ$. Kendi i kerkuar ne DST eshte i perfshire ne diapazonin e ofruar por eshte edhe me shume, duke favorizuar dhe mundesuar teknike operimi specifike ekstra.

Operatori mund ta kryeje ne menyre te qarte kete levizje duke filluar nga 0° e deri ne 15° apo 20° sic edhe kerkohet, madje duke e tejkeluar kete vlere kendore deri ne 30° (majtas ose djathtas).

I taken operatorit te specializuar, qe do perdor kete aparat, te percaktoje nese eshte i interesuar te perdore kendin e levizjes pergjate aksit horizontal (Lateral Tilt Left/Right) te shtratit nga 0° deri ne 15° apo 20° (majtas / djathtas) sikurse eshte minimumi i kerkuar ne specifikimet e DST, apo mundesine ekstra qe te ofron ky shtrat deri ne 30° , per teknika me te specializuara operimi. Rrjedhimisht, duket qarte qe ky kriter i kerkuar plotesohet dhe tejkalohe, duke ofruar nje levizje laterale (anesore) 30° majtas dhe 30° djathtas, duke e arritur ne kete menyre diapazonin e kerkuar nga AK (15° - 20°), dhe duke e tejkeluar ate.

3. *Ne lidhje me pretendimin e trete te mosplotesimit te kriterit: "Rrotullimi i piastres se kembeve duhet te jete deri ne 90° dhe jo 180° sic eshte paraqitur", po ju japim sqarimet tona si ne vijim: Per sa i perket artikullit Nr. 1 "Shtreter Operatore per salle operacioni per perdorim kirurgjie te pergjithshme", specifikimi i kerkuar per kete produkt ne Shtojcen e paraqitur ne APP te dates 11.02.2021 ka qene:*

Rrotullimi i piastres se kembes (Leg Plate outward)

Rrotullimi i piastres se kembes duhet te jete me e vogel ose e barabarte me 90°

Produkti i ofruar nga kompania jone, ashtu sic edhe paraqitet ne katalogun "Katalog Alvo_Art 1_2" e ka kete specifikim te shprehur ne vleren 180° (Foot rest abduction).


Ky parameter eshte i shprehur ne katalog si vlere totale e levizjes anesore te pjeseve te kembeve. Levizjet e piastrave behen: Piastra e majte leviz ne planin horizontal ne kendin 0 - 90° (sens kunderorar ne lidhje me aksin e shtratit) dhe pjastra e djathte gjithashtu ne kendin 0 - 90° (sens orar ne lidhje me aksin e shtratit).

Pra del qarte se levizjet e piastrave te kembeve behen sikurse jane kerkuar ne specifikimet teknike te DST, duke plotesuar 100% kete specifikim, me e vogel ose e barabarte me 90° , kundrejt aksit te krevatit. Eshte e pamundur teknikisht qe rrotullimi i piastrave te jete me i madh se 90° kundrejt aksit.

Levizja e pergjithshme anesore e piastrave te kembeve ne raport me njera-tjetren eshte 180° , pasi jane hapur plotesisht secila piastra ne planin horizontal 90° kundrejt aksit te krevatit, sikurse eshte specifikuar ne DST.

Me poshte edhe ilustrimi me figure i levizjeve kendore te ketyre piastrave ne rrafshin horizontal sipas pamjes se marre nga siper.

Steep tilts



Pra, duket qarte qe ky kriter permbushet plotesisht nga produkti i ofruar nga kompania jone, pikerisht sipas kerkesave te paraqitura ne DST dhe shtojcen perkatese [...]”.

II.4. Nëpërmjet shkresës nr. 204 prot., datë 09.03.2021 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit si vijon:

“ [...]

Komisioni i shqyrtimit te ankeses vlereson si me poshte pretendimin e operatorit ekonomik. Artikulli Nr.3 Ndricules per sallat e operacionit "Diametri i fushes se drites eshte 120-350 mm", operatori ekonomik pretendon se kete kriter e ploteson 100% sipas kerkesave te DST. Sipas specifikimeve teknike per Ndriculeset e Salles se Operacionit kerkohet qe "Diametri i fushes se drites (Light Field Diameter) minimalisht ne diapazonin (1.70-150mm) me shume se 280 mm i rregullueshem.

Ne si komision e vleresojme te drejte kete pretendim, duke qene se operatori ekonomik e permbush kete specifikim teknik ku ofron nje diameter te fushes se drites 120-350 mm brenda diapazonit te kerkuar ne DST.

Artikulli nr.1. "Shtrat Operator per sallat e operacionit per perdorim kirurgjie te pergjithshme". Kendi i levizjes pergjate aksit horizontal (Lateral Tilt Left/Right) majtas/djathtas nuk perputhet sepse eshte +/- 30°.

Duke u bazuar ne specifikimin teknik per artikullin e mesiperrn cilesohet se:

Kendi i levizjes pergjate aksit horizontal (Lateral Tilt Left/Right)

Majtas nga 15°-20°

Djathtas nga 15°-20°

Komisioni vlereson te padrejte kete pretendim perderisa specifikimi i ofruar nga operatori ekonomik me kend +/- 30° nuk eshte brenda parametrave te kerkuar ne specifikimet e DST-ve ku kendi duhet te jete 15°-20°.

Komisioni i shqyrtimit te ankesave duke u bazuar ne vleresimet e bera nga inxhinieri vendosi ta rrezoje kete pike.

Artikulli nr.1 Shtrat Operator per sallen e operacionit per perdorim kirurgjie te pergjithshme Rrotullimi i piastres se kembeve duhet te jete deri ne 90° dhe jo 180°.

Pas verifikimeve te bera nga komisioni si dhe nga vleresimi i bere nga inxhinieri konstatojme si me poshte:

Ne katalogun e paraqitur ne sistemin elektronik vihet re qe rrotullimi i piastres se kembes eshte 180°. Ne specifikimet teknike te DST-ve eshte e shprehur qarte qe rrotullimi i piastres se kembes duhet te jete me e vogel ose e barabarte me 90°. Komisioni vlereson te padrejte kete pretendim perderisa specifikimi i ofruar nga operatori ekonomik nuk perputhet me parametrat e kerkuar ne specifikimet e DST-ve.

Per sa me siper bie poshte pretendimi i operatorit ekonomik.

Ankesa e OE Biometric Albania SHPK nuk qendron ne pikat 2 dhe 3.

Per sa me siper pretendimet e operatorit ekonomik nuk qendrojne. Autoriteti Kontraktor vendosi te mos e pranoje ankesen e Operatorit Ekonomik.”

II.5. Në datën 24.03.2021 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar arsyen e dytë dhe të tretë të skualifikimit të tij.

II.6. Në datën 06.04.2021 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 461/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 801/2 prot., datë 02.04.2021, bashkëngjitur informacioni e dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

II.7. Nëpërmjet shkresës Nr.prot 461/4, datë 07.05.2021, Komisioni i Prokurimit Publik i është drejtuar z.N. Hyka, ekspert pranë Universitetit Politeknik të Tiranës, duke i kërkuar shprehimisht si vijon:

“Komisionit të Prokurimit Publik në kuadër të shqyrtimit të ankesës së paraqitur nga një operator ekonomik, i shfaqet nevoja e kryerjes së procedurës së hetimit administrativ, lidhur me pretendimet e ngritura. Gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës konstatojmë se nga ana e operatorit ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë, në përmbushje të kriterëve kualifikuese, ku përveç të tjerave, janë ngritur pretendime edhe në lidhje me specifikimet teknike për pajisje mjekësore dhe kryesisht me faktin e plotësimit/mosplotësimit të specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoritetit kontraktor, si dhe verifikimin e katalogut të paraqitur për pajisjen:

1. Shtretër operatorë për sallë operacioni për përdorim kirurgjie të përgjithshme Sa më sipër, në zbatim të nenit 19/1 e vijues të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, neneve 80, 81 dhe 86 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenit 24, pika 2 të ligjit nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, kërkojmë nga ana juaj si ekspert në Universitetin Politeknik të Tiranës, brenda datës 10.05.2021, ora 16.00, të njiheni me specifikimet teknike të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, si dhe dokumentacionin (katalogët) e dorëzuar në sistem nga operatori ekonomik ankimues për procedurën e mësipërme të prokurimit. Gjithashtu, duhet të shpreheni në lidhje me kostot financiare të kryerjes së këtij shërbimi.”

II.8. Në datën 10.05.2021, në ambientet e Komisionit të Prokurimit Publik, u paraqit eksperti në Universitetin Politeknik të Tiranës, Z. N Hyka, i cili u njoh me specifikimet teknike të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues, si dhe dokumentacionin (katalogët), të dorëzuara në sistem nga operatori ekonomik ankimues për procedurën e mësipërme të prokurimit. Referuar procesverbalit të mbajtur në këtë takim, eksperti brenda dy ditëve, duhet të shprehet në lidhje me kryerjen e këtij shërbimi dhe kostot financiare të tij.

II.9. Në datën 11.05.2021, është protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresa me objekt *“Propozim kosto shërbimi”*, ku eksperti Dr. N Hyka, Ekspert i Pajisjeve Mjekësore, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës njofton se: *[...] ...kostoja e këtij shërbimi është 10000 lekë dhe koha e nevojshme për kryerjen e kësaj ekspertize është 2 (dy) ditë pune [...].”*

II.10. Në datën 11.05.2021 Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin e ndërmjetëm K.P.P. 461/5, ku vendosi:

- 1. Të urdhërojë kryerjen e verifikimit të katalogëve të paraqitur nga operatori ekonomik “Biometric Albania” SHPK, nga eksperti për pajisjet mjekësore në Universitetin Politeknik të Tiranës, për procedurën e prokurimit me Nr.REF-84273-01-19-2021, me objekt: “F.V pajisje per sallat operatore te Spitalit Rajonal Shkodër”, me fond limit 41 632 222.22 lekë pa TVSH, zhvilluar me date 17.02.2021, nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Shkodër.*
- 2. Operatori ekonomik “Biometric Albania” SHPK të parapaguajë për llogari të ekspertit Niko Hyka, të Universitetit Politeknik të Tiranës, shumën prej 10000 lekë si tarifë e përcaktuar me anë të shkresës të protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik datë 11.05.2021 për verifikimin e katalogëve të dorëzuar në procedurën e prokurimit objekt ankimi dhe të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, së bashku me kopje të faturës financiare të parapagimit brenda datës 17.05.2021 ora 14:00.*
- 3. Në datën 17.05.2021 ora 14:00 të paraqiten pranë Komisionit të Prokurimit Publik përfaqësues të autoritetit kontraktor Spitali Rajonal Shkodër dhe të operatorit ekonomik “Biometric Albania” SHPK, shoqëruar me autorizim të posaçëm.*
- 4. Të njoftojë ekspertin për kryerjen e vlerësimit të dokumentacionit të mësipërm.*

II.11. Në datën 17.05.2021 në mjediset e Komisionit të Prokurimit Publik, u mbajt Seanca Dëgjimore midis përfaqësuesit të operatorit ekonomik ankimues, përfaqësuesve të autoritetit kontraktor, ekspertit dhe anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik. Në seancën dëgjimore Komisioni i drejtoi pyetjet ekspertit, me qëllim kryerjen nga ana këtij të fundit të ekspertizës teknike të posaçme, mbi përputhshmërinë e specifikimeve teknike të vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, me specifikimet teknike të pajisjeve të dorëzuara nga

operatori ekonomik “Biometric Albania” SHPK. Për këtë qëllim ekspertit si dhe iu vunë në dispozicion në formë elektronike dhe të printuar: katalogët e dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “Biometric Albania” SHPK; Oferta Teknike e dorëzuar nga operatori ekonomik “Biometric Albania” SHPK si dhe dokumentet e procedurës së prokurimit përfshirë specifikimet teknike.

II.12. Nëpërmjet shkresës së protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 461/7 prot., datë 20.05.2021, është depozituar pranë KPP dokumenti “Ekspertizë vlerësimi” i ekspertit Z.N. Hyka, ku ky i fundit është përgjigjur në lidhje me pyetjet e ngritura, sipas procesverbalit të mbajtur në seancën dëgjimore me datë 17.05.2021, në mjediset e KPP-së.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues se: *“Shtretërit e kirurgjisë së përgjithshme nuk përputhen sepse këndi i lëvizjes përgjatë aksit horizontal majtas/djathtas është 30°”,* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 9 *“Kriteret e Veçanta për Kualifikim”, “Kapaciteti teknik”,* pika 9., të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi, është parashikuar plotësimi i kërkesës si më poshtë vijon:

“9.Për të gjithë artikujt e ofruar te paraqiten kataloge, ku te përfshihen edhe specifikimet teknike te hollësishme për secilin artikull (pjeset e katalogut qe permbajne emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike te artikullit qe ofertohe, nese nuk jane ne gjuhen shqipe, te perkthehen ne gjuhen shqipe dhe te noterizohen). Operatori ekonomik duhet te markoje ne katalogun perkates produktet qe ofron sipas numrit rendor (te markuara sipas artikullit) te percaktuar ne formularin e ofertes. Katalogjet do pranohen vetem ne forme elektronike nepermjet sistemit elektronik te prokurimit”.

III.1.2. Në shtojcën 10, *“Specifikime teknike”* të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi, të publikuara në datën 20.01.2021, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët "ose ekuivalent" të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, parametrat teknik etj.:

Nr.	Pershkrimi I produktit	Njesia	Sasia	Cmimi /per njesi	Totali/ pa Tvsh
1	Shtreter operatore per salle operacioni per perdorim kirurgjie te pergjithshme	cope	4		
2	Shtreter operatore per salle operacioni per perdorim kirurgjie ortopedike	cope	1		
3	Ndricules per sallat e operacionit	cope	5		
4	Harku C (C- Arm) per sallat operatore	cope	1		
5	Aparate Narkoze	cope	5		
				Totali pa Tvsh	41,632,222.22

*Specifikimet teknike përkatëse për procedurën e prokurimit **Objekt :F.V pajisje per sallat operatore te Spitalit Rajonal Shkoder** si më poshtë:*

Shtreter Operatore per salle operacioni per perdorim kirurgjie te pergjithshme.

Numri I Shtreterve Operatore: Cope 4

Karakteristikat:

- 1.Dizajn modern*
- 2.Dyshek i perbere me material memorie qe kthehet ne vend kur nuk ushtrohet trysni*
- 3.Materiali i Dyshekut duhet te jete rezistent kundrejt agjenteve sterilizues.*
- 4.Tavolina,bazamenti,dhe aksesoret duhet te jene te thjeshte per tu pastruar dhe sterilizuar.*
- 5.Baza e shtratit dhe kolona duhet te jene te perbere nga material celiku (stainless steel).*
- 6.Shtrati operator duhet te jete i pajisur me rrota dhe frena te rrotave per fiksimin e tij ne vend.*
- 7.Duhet te jete i motorizuar dhe i pajisur me nje panel kontrolli.*
- 8. I gjithë trupi i shtratit eshte radiolucet nga rrezet x.*
- 9. I pajisur me shiringa anesore per aksesoret.*

Aksesoret Standard qe duhet te vijne bashke me tavolinen Operatore:

- a.Anesthetic Screen cope 1*
- b.Boddy Support cope 2*
- c.Shoulder Support cope 2*
- d.Arm Support cope 2*
- e.Leg Support cope 2*
- f.Foot Support cope 2*
- g.Kidney Bridge cope 1*
- h.Fixing Clamps cope 8*
- j.Hand Remote Control cope 1*
- k.Matters cope 1 set*

Specifikime te tjera:

Table Top

- 1.Gjatesia e shtratit jo me pak se 2000mm.*
- 2.Gjeresia e shtratit jo me pak se 500mm*

Heigh Adjustment

- 3.Ulja e shtratit ne pozicion vertikal jo me shume se 500mm nga dyshemeja*
- 4.Ngritja e shtratit ne pozicion vertikal jo me pak se 1000mm*

Patient Weight/Load Capacity

- 5.Pesha mbajtese e shtratit jo me pak se 200 kg*

Levizjet e Shtratit

- 6.Levizja Tendelenburg/Reverse Tendelenburg jo me shume ose e barabarte me +/- 35°*
- 7.Levizja e pjeses se kokes(Head Plate Up/Down)*
- Lart nga 0° deri ne 45° sipas modelit te shtratit*
- Poshte nga 0° deri ne 90° sipas modelit te shtratit*

- 8.Seksioni I poshtem(Back Section Adjustment Up/Down)
Lart jo me shume ose deri ne 90°.Poshte jo me shume ose deri ne -45°
- 9.Seksioni qe mban kembet(Leg Plate Up/Doën)
Lart jo me shume ose e barabarte me 20°
Poshte jo me shume ose e barabarte me 90°
- 10.Kendi I levizjes pergjate aksit horizontal(Lateral Tilt Left/Right)
Majtas me I vogel ose I barabarte me 20°
Djathtas me I vogel ose I barabarte me 20°
- 11.Reshqitja(Levizja) horizontale e shtratit(Horizontal Sliding)
Levizja horizontale deri ne 350mm
- 12.Rrotullimi I pjastres se kembes(Leg Plate outward)
Rrotullimi I pjastres se kembes duhet te jete me I vogel I barabarte me 90°

III.1.3. Në datën 11.02.2021 autoriteti kontraktor ka publikuar një shtojcë në SPE, duke bërë modifikimin e specifikimeve teknike për pajisjen objekt ankimimi, si më poshtë vijon:

1.Shtreter Operatore per salle operacioni per perdorim kirurgjie te pergjithshme.

Numri i Shtreterve Operatore:

Karakteristikat

9.I pajisur me shina anesore

Table Top

Shtreter operatore per salle operacioni per perdorim kirurgjie te pergjithshme

3.Ulja e shtratit ne pozicion vertikal ne nje vlere ne diapazonin 500-700mm nga dyshemeja

6.Levizja Tendelenburg/Reverse Tendelenburg ne diapazon +/-25°-40°

7.Levizja e pjeses se kokes(Head Plate Up/Down)

Lart nga 0° deri ne(40°-45°) sipas modelit te shtratit

Poshte nga 0° deri ne(45°-90°)sipas modelit te shtratit

8.Seksioni I poshtem(Back Section Adjustment Up/Down)

Lart deri ne 80- 90°.Poshte jo me pak ose e barabarte me -45°

9.Seksioni qe mban kembet(Leg Plate Up/Down)

Lart nga 0° deri ne (15°- 20°)

Poshte nga 0° deri ne (80°-90°)

10.Kendi I levizjes pergjate aksit horizontal(Lateral Tilt Left/Right)

Majtas nga 15°-20°

Djathtas nga 15°-20°

11.Reshqitja(Levizja) horizontale e shtratit(Horizontal Sliding)

Levizja horizontale deri ne (300 mm-350 mm)

12.Rrotullimi i pjastres se kembes(Leg Plate outward)

Rrotullimi i pjastres se kembes duhet te jete me e vogel ose e barabarte me 90°

III.1.4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Biometric Albania” SHPK, në përmbushje të kriterit të mësipërm, rezulton se është praqitur si vijon:

- Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike;
- Ofertë Teknike e operatorit ekonomik “Biometric Albania” SHPK;
- Dokumenti “Katalog _Alvo _Art _1 _2.pdf”

III.1.5. Në nenin 46, pika 1/b e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... .”*

III.1.6. Në nenin 27 “Kontratat e mallrave”, në pikën 6 të nenit 27 “Kontratat e mallrave”, të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se: *“Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*

- a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose*
- b) dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogët teknike; dhe/ose*
- c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”*

III.1.7. Operatori ekonomik ankimes në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor pretendon: *Ne lidhje me pretendimin e mosplotesimit të kriterit "Shtreterit e kirurgjise se pergjithshme nuk perputhen sepse kendi i levizjes pergjate aksit horizontal majtas/djathtas eshte*

30°", po ju japim sqarimet tona si ne vijim: Per sa i perket artikullit Nr.1 "Shtreter Operatore per salle operacioni per perdorim kirurgjie te pergjithshme", specifikimi i kerkuar per kete produkt, ne Shtojcen e paraqitur ne APP te dates 11.02.2021 ka qene:

Kendi i levizjes pergjate aksit horizontal (Lateral Tilt Left/Right)

Majtas nga 15°-20°

Djathtas nga 15°-20°

Produkti i ofruar nga kompania jone, ashtu sic edhe paraqitet ne katalogun "Katalog Alvo_Art 1_2", e ka kete specifikim te rregullueshem ne diapazonin 30° / -30° (Lateral Tilt Adjustment).

Technical parameters ALVO Etiuda		
1	Tabletop length	2100 mm
2	4, 5 sections	2200 mm
	6 sections	
	Tabletop width	500 mm
	Tabletop width (with side rails)	560 mm
3-4	Height adjustment (without pads) - Mobile base, tables with manual longitudinal shift	700 - 1030 mm
	Height adjustment (without pads) - Mobile base, tables with powered longitudinal shift	730 - 1060 mm
	Height adjustment range (without pads) - Supermobile base, tables with manual longitudinal shift	700 - 1030 mm
	Height adjustment range (without pads) - Mobile base, manual longitudinal shift, double electrohydraulic column	615 - 1065 mm
8	Back rest adjustment	85° / -45°
9	Foot rest adjustment	20° / -90°
12	Foot rest abduction	180°
10	Lateral tilt adjustment	30° / -30°
7	Head rest adjustment	45° / -45°

The right to

Pra, kompania jone ka ofruar nje produkt me nje diapazon me te gjere te kesaj levizje, qe ploteson 100% specifikimet e kerkuara dhe i tejkalon ato, pa kerkuar kosto shtese.

Levizja laterale (anesore) prej ±30° perben nje avantazh, sidomos ne nderhyrjet kirurgjikale nefrologjike-urologjike, ku eshte i nevojshem rrotullimi anesor i shtratit ne nje kend me te gjere se ai i kerkuar 20° / -20°. Kendi i kerkuar ne DST eshte i perfshire ne diapazonin e ofruar por eshte edhe me shume, duke favorizuar dhe mundesuar teknike operimi specifike ekstra.

Operatori mund ta kryeje ne menyre te qarte kete levizje duke filluar nga 0° e deri ne 15° apo 20° sic edhe kerkohet, madje duke e tejkaluar kete vlere kendore deri ne 30° (majtas ose djathtas).

I taken operatorit te specializuar, qe do perdore kete aparat, te percaktoje nese eshte i interesuar te perdore kendin e levizjes pergjate aksit horizontal (Lateral Tilt Left/Right) te shtratit nga 0°

deri ne 15° apo 20° (majtas / djathas) sikurse eshte minimumi i kerkuar ne specifikimet e DST, apo mundesine ekstra qe te ofron ky shtrat deri ne 30°, per teknika me te specializuara operimi. Rrjedhimisht, duket qarte qe ky kriter i kerkuar plotesohet dhe tejkalohe, duke ofruar nje levizje laterale (anesore) 30° majtas dhe 30° djathtas, duke e arritur ne kete menyre diapazonin e kerkuar nga AK (15°-20°), dhe duke e tejkeluar ate.

Ne lidhje me pretendimin e mosplotesimit te kriterit: "Rrotullimi i piastres se kembeve duhet te jete deri ne 90° dhe jo 180° sic eshte paraqitur", po ju japim sqarimet tona si ne vijim:

Per sa i perket artikullit Nr. 1 "Shtreter Operatore per salle operacioni per perdorim kirurgjie te pergjithshme", specifikimi i kerkuar per kete produkt ne Shtojcen e paraqitur ne APP te dates 11.02.2021 ka qene:

Rrotullimi i pjastres se kembes (Leg Plate outward)

Rrotullimi i pjastres se kembes duhet te jete me e vogel ose e barabarte me 90°

Produkti i ofruar nga kompania jone, ashtu sic edhe paraqitet ne katalogun "Katalog Alvo_Art 1_2" e ka kete specifikim te shprehur ne vleren 180° (Foot rest abduction).


Ky parameter eshte i shprehur ne katalog si vlere totale e levizjes anesore te pjeseve te kembeve. Levizjet e pjastrave behen: Pjastra e majte leviz ne planin horizontal ne kendin 0-90° (sens kunderor ne lidhje me aksin e shtratit) dhe pjastra e djathte gjithashtu ne kendin 0-90° (sens orar ne lidhje me aksin e shtratit).

Pra del qarte se levizjet e pjastrave te kembeve behen sikurse jane kerkuar ne specifikimet teknike te DST, duke plotesuar 100% kete specifikim, me e vogel ose e barabarte me 90°, kundrejt aksit te krevatit. Eshte e pamundur teknikisht qe rrotullimi i pjastrave te jete me i madh se 90° kundrejt aksit.

Levizja e pergjithshme anesore e pjastrave te kembeve ne raport me njera-tjetren eshte 180°, pasi jane hapur plotesisht secila piaster ne planin horizontal 90° kundrejt aksit te krevatit, sikurse eshte specifikuar ne DST.

Me poshte edhe ilustrimi me figure i levizjeve kendore te ketyre pjastrave ne rrafshin horizontal sipas pamjes se marre nga siper.

Steep tilts



Pra, duket qarte qe ky kriter permbushet plotesisht nga produkti i ofruar nga kompania jone, pikerisht sipas kerkesave te paraqitura ne DST dhe shtojcen perkatese [...].

III.1.8. Autoriteti kontraktor në kthim përgjigje argumenton: “*Artikulli nr.1. “Shtrat Operator per sallen e operacionit per perdorim kirurgjie te pergjithshme”. Këndi i levizjes pergjate aksit horizontal (Lateral Tilt Left/Right) majtas/djathtas nuk perputhet sepse eshte +/- 30°.*

Duke u bazuar ne specifikimin teknik per artikullin e mësipërm cilesohet se:

Këndi i levizjes pergjate aksit horizontal (Lateral Tilt Left/Right)

Majtas nga 15°-20°

Djathtas nga 15°-20°

Komisioni vlereson te padrejte kete pretendim perderisa specifikimi i ofruar nga operatori ekonomik me kend +/- 30° nuk eshte brenda parametrave te kerkuar ne specifikimet e DST-ve ku kendi duhet te jete 15°-20°.

Komisioni i shqyrtimit te ankesave duke u bazuar ne vleresimet e bera nga inxhinieri vendosi ta rrezoje kete pike.

Artikulli nr.1 Shtrat Operator per sallen e operacionit per perdorim kirurgjie te pergjithshme Rrotullimi i piastres se kembeve duhet te jete deri ne 90° dhe jo 180°.

Pas verifikimeve te bera nga komisioni si dhe nga vleresimi i bere nga inxhinieri konstatojme si me poshte:

Ne katalogun e paraqitur ne sistemin elektronik vihet re qe rrotullimi i piastres se kembes eshte 180°. Ne specifikimet teknike te DST-ve eshte e shprehur qarte qe rrotullimi i piastres se kembes duhet te jete me e vogel ose e barabarte me 90°. Komisioni vlereson te padrejte kete pretendim perderisa specifikimi i ofruar nga operatori ekonomik nuk perputhet me parametrat e kerkuar ne specifikimet e DST-ve.

Per sa me siper bie poshte pretendimi i operatorit ekonomik.

Ankesa e OE Biometric Albania SHPK nuk qendron ne pikat 2 dhe 3.

Per sa me siper pretendimet e operatorit ekonomik nuk qendrojne. Autoriteti Kontraktor vendosi te mos e pranoje ankesen e Operatorit Ekonomik.”

III.1.9. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës objekt shqyrtimi, KPP vëren se, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi duhet të paraqesin “*Për të gjithë artikujt e ofruar te paraqiten katalogë, ku te përfshihen edhe specifikimet teknike te hollësishme për secilin artikull*”. Konkretisht, nisur nga arsyet e skualifikimit, në specifikimet teknike të modifikuara për pajisjen: “*Shtreter Operatore per salle operacioni per perdorim kirurgjie te pergjithshme*” nga autoriteti kontraktor, përveç të tjerave, ky i fundit ka përcaktuar kërkesat:

- *Këndi i levizjes pergjate aksit horizontal(Lateral Tilt Left/Right)*

Majtas nga 15°-20°

Djathtas nga 15°-20°

Rrotullimi i pjastres se kembes(Leg Plate outward)

Rrotullimi i pjastres se kembes duhet te jete me e vogel ose e barabarte me 90°

KPP sqaron se, qëllimi i këtij kriteri është që nëpërmjet katalogëve të kërkuar, të verifikohen specifikimet teknike të produkteve të ofruara nga operatorët ekonomikë, për të parë përputhshmërinë e tyre me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit për këto pajisje.

III.1.10. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Biometric Albania” SHPK, konstatohet se, ky i fundit, për të plotësuar kriteret e mësipërme ka paraqitur deklaratë për përmbushjen e specifikimeve teknike, katalogun përkatës për pajisjen: “*Shtreter Operatore per salle operacioni per perdorim kirurgjie te pergjithshme*”, si dhe ofertën teknike. Konkretisht, referuar dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Biometric Albania” SHPK, pretendimeve të këtij të fundit, si dhe raportit të dorëzuar nga eksperti i fushës, konstatohet se për përmbushjen e specifikimeve teknike të pajisjes në fjalë “*Kendi i levizjes pergjate aksit horizontal(Lateral Tilt Left/Right):Majtas nga 15°-20°; Djathtas nga 15°-20° dhe Rrotullimi i pjastres se kembes(Leg Plate outward): Rrotullimi i pjastres se kembes duhet te jete me e vogel ose e barabarte me 90°*”, operatori ekonomik ka paraqitur katalogun e kompanisë prodhuese Alvo. Nga shqyrtimi i këtij katalogu konstatohet se produkti i ofruar nga shoqëria ankimuese e ka kendin e levizjes ne diapazonin 30° / -30° (Lateral Tilt Adjustment) dhe për sa i përket kërkesës që rrotullimi i pjastrës së kembes duhet të jetë më e vogël ose e barabarte me 90°, produkti i ofruar e ka këtë specifikim të shprehur ne vlerën 180° (Foot rest abduction).

Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, nisur nga specifika dhe kompleksiteti i objektit të prokurimit për procedurën objekt shqyrtimi, për verifikimin e specifikimeve teknike iu drejtua një eksperti të pavarur, me qëllim ekspertizën teknike të posaçme, mbi përputhshmërinë e specifikimeve teknike të vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, me specifikimet teknike të pajisjeve të dorëzuara nga operatori ekonomik “Biometric Albania” SHPK. Në raportin e ekspertit të posaçëm, thuhet se:

“*[...]Shtrati operator ose sic njihen ndryshe tavolina kirurgjikale eshte nje pajisje qe vendoset kryesisht ne sallen e operacionit te nje institucioni shendetesor i cili ofron kete kategori sherbimesh. Shtrati kirurgjikal mund te jete statik ose i levizshem per te levizur nga nje dhome ne nje tjeter. Shtreterit kirurgjikale perdoren ne nje game te gjere te procedurave operatore. Disa nga specifikat kryesore qe diferencojne modelet nga njeri - tjetri jane: gjatesia e shtratit, gjeresia e shtratit, (pa perfshire shinat anesore), lartesia e shtratit, levizshmeria sipas shtratit-majtas-djathtas, mbeshetja e kokes, mbeshetja e shpines, mbeshetjet e kembeve, etj, pesha mbajtese, elemente per vendosjen e aksesoreve shtese, sistemi i komandimit per levizje ne drejtime te ndryshme sipas nevojave te nderhyrjes tek pacienti etj.*

1. *Ne specifikimet teknike te kerkuara nga autoriteti kontraktor eshte kendi i levizjes pergjate aksit horizontal majtas nga majtas nga 15° - 20°, djathtas nga 15° - 20° (shtojca 10 DST).*

[...] Lidhur me pyetjen se a i permbush pajisja ne katalog specifikimet teknike te kerkuara nga autoriteti kontraktor ne lidhje me kendin e levizjes pergjate aksit horizontal (lateral tilt left/right), rezulton se vlerat e paraqitura jane te ndryshme pertej limitit te percaktuar nga AK prej 20°. Pavaresisht ketij ndryshimi, pajisja i permbush specifikimet teknike te kerkuara nga autoriteti kontraktor ne lidhje me kendin e levizjes pergjate aksit horizontal, pasi ofron nje interval me te madh perdorimi te pjerresise se sipas boshtit te shtratit.

2. Ne specifikimet teknike te kerkuara nga autoriteti kontraktor, rrotullimi i piastres se kembes duhet te jete me e vogel ose e barabarte me 90°, (shtojca 10 DST).

[...] Ne katalogun e specifikimeve teknike (fq.7), OE ka markuar per kete kerkese (8 & 12), rregullimi i mbajteses se kembes jepet ne intervalin +20° ÷ - 90° dhe maksimumi 180 per hapjen anesore te saj (per rrotullimin rreth boshtit horizontal (levizjet lart poshte te cilat jane ne vlerat +20° ÷ - 90°), per rrotullimin rreth boshtit vertikal (levizjet mund te kryhen ne diapazonin 0° ÷ 180°).

Nga sa me siper, lidhur me pyetjen se a i permbush pajisja e ofruar nga shoqeria "Biometric Albania SHPK", specifikimet teknike te kerkuara nga autoriteti kontraktor ne lidhje me rrotullimin e piastres se kembes (leg plate outward), rezulton se vlerat e paraqitura nuk rezultojne te ndryshme dhe se pajisja i permbush specifikimet teknike te kerkuara nga autoriteti kontraktor.

Parametrat e kerkuar jane dhene ne interval me te gjere vlerash dhe nuk cenojne funksionalitetin e pajisjes. Nga sa me siper, ato e permbushin qellimin dhe funksionalitetin e pajisjes se kerkuar.

Parametrat e kerkuar nga autoriteti kontraktor jane dhene me emertime (Leg Plate Outward - hapje anesore nga jashte) nga AK dhe (foot rest abduction - hapja e plote e mbajtese te kembeve) nga OE. Nderkohe ekziston dhe opsioni "Inward (nga brenda) "per vendosjen kembe permbi kembe". Pra 90 grade outward dhe 90 grade inward, eshte ekuivalente me 180 grade e ngjashme me opsionin "abduction", duke i llogaritur nga boshti i trupit.

Nuk rezultojne te dhena te paplota lidhur me paisjen e propozuar nga ankimuesi per dy treguesit e mesiperm.”

III.1.11. Për sa më sipër, referuar kërkesave të autoritetit kontraktor të parashikuar në specifikimet teknike të dokumenteve të tenderit, dokumentacionin katalogë për pajisjet e ofruara nga ankimuesi si dhe referuar ekspertizës së vlerësimit së dhënë nga eksperti N. Hyka, për pajisjen: “Shtretër operatorë për sallë për përdorim kirurgjie të përgjithshme” evidentohet se pajisja e ofruar nga ankimuesi nuk cenon dhe nuk ka ndikim në cilësinë dhe qëllimin për të cilin do të përdoret pajisja e kërkuar, si dhe nuk ndryshon kushtet, karakteristikat, kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, duke mos penguar funksionimin normal të pajisjes.

KPP sqaron se, kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me

sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Gjithashtu, kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik disponon pajisje me parametrat e kërkuar, me qëllim funksionimin normal të tyre, si edhe për të kryer edhe funksionin për të cilin do të merren. Autoriteti kontraktor, duhet të udhëhiqet nga parimi i mirëpërdorimit të fondeve publike dhe përfitimi i një produkti me cilësi të mirë dhe me çmim më të ulët, si edhe nuk duhet të gjykojë në mënyrë sipërfaqësore e formale. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, parametrat e pajisjes së ofruar nga operatori ekonomik ankimues duhen analizuar në funksion të qëllimit dhe përdorimit të saj, duke analizuar edhe faktin e mosndikimit në qëllimin, kushtet dhe përdorimin e kësaj pajisjeje.

Sa më sipër analizuar, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues përmbush kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Rrjedhimisht, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 "*Për miratimin e rregullave "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik"*", Neni 4, Vendim i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*", Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "Biometric Albania" SHPK për procedurën e prokurimit me Nr.REF-84273-01-19-2021, me objekt: "*F.V pajisje për sallat operatore të Spitalit Rajonal Shkodër*", me fond limit 41 632 222.22 lekë pa TVSH, zhvilluar me date 17.02.2021, nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Shkodër.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik "Biometric Albania" SHPK, duke e kualifikuar atë.

3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Biometric Albania” SHPK.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 461 Protokolli

Datë 24.03.2021

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar	Anëtar	Anëtar
Vilma Zhupaj	Lindita Skeja	Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri